



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8489 Prot.

Roskovec, më 29.10 2024

VENDIM

NR 63. DATË 28.10. 2024

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN SHTATOR 2024”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.09.2024, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Shtator 2024.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7800/1 Prot.

Roskovec, më 01.10.2024

Procesverbal Nr.10

-I mbajtur sot, datë 30.09.2024, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2024.
5. Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur midis Bashkisë Roskovec dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me Nr.7456 Prot datë 19.08.2024 të Bashkisë Roskovec, Nr.10813 Prot datë 10.09.2024 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
6. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.
7. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.108 datë 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjeve vartëse, për vitin 2024”.
8. Për miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA 2025-2027.
9. Për ndryshimin e emërtimit të disa rrugëve në Bashkinë Roskovec.
10. Raport i monitorimit për 4-mujorin e II viti 2024.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13¹⁰

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, A.Pelo S.Bibo Qamili, F.Feleqi, Zh.Metushi.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, Rr.Hazizi, E.Xhaxhaj, V.Çepele.

Prezent nga bashkia: Kryetarja M.Bufi, Nënkryetari M.Goga, Sekretare e Përgjithshme D.Hoxha Dr.Ekonomisë S.Çepele, P/Shërbimit Social S.Saliaj, P/Menaxhimit të Pronave E.Kocaqi.

Me plotësimin e kuorunit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 16 këshilltar. Kryetari – të nderuar këshilltar, e nderuar Kryetare e Bashkisë Roskovec, të nderuar specialist, punonjës të Bashkisë Roskovec, faleminderit që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit

Bashkiak të datës 30.09.2024. Për procedurë ju ftoj të gjithëve, pasi jeni njohur me rendin e ditës njoftuar datë 24.09.2024, ka dikush ndonjë pyetje apo diskutim në lidhje me rendin e ditës? Jorgo- në tre mbledhje të Kryetarëve të Grupeve është ngritur një shqetësim, dhe ky shqetësim nga Nënkryetari na është thënë që do zgjidhet, është nevoja ta diskutojmë? Kryetari- do diskutohet shqetësimi juaj në momentin e duhur. Ishte për procedurë dhe për rendin e ditës, e kërkon njeri fjalën? Nuk ka pyetje dhe diskutime.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 16 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2024.

Sekretarja e Këshillit sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar, vendimet normative si dhe miratimin e tyre nga Prefektura.

3..Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari pyet nëse ka pyetje apo diskutime. Nuk ka. Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 16 vota pro.

4.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2024.

P/Shërbimit Social Sidorela sqaron projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur. Kryetari-e kërkon dikush fjalën për pyetje apo diskutime? Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 16 vota pro.

5. Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur midis Bashkisë Roskovec dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me Nr.7456 Prot datë 19.08.2024 të Bashkisë Roskovec,Nr.10813 Prot datë 10.09.2024 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Sek.Përgjithshme Delina – ju kemi paraqitur për miratim marrëveshjen e bashkëpunimit të Bashkisë Roskovec me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kjo marrëveshje vjen pas miratimit të VKM-së 435 datë 26.06.2024 për procedurën e bashkëpunimit me institucionet e administratës shtetërore. Në zbatim të këtij vendimi ASHK-ja dhe bashkitë do të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtaritë administrative në kuadër të trajtimit me prioritet dhe përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban, për të cilat janë miratuar dokumenta të planifikimit të territorit, si dhe për zonat informale në të cilat evidentohen një numër i konsiderueshëm ndërtime pa leje. Situata aktuale për rastet e hapura në Bashkinë Roskovec janë 1593 aplikime për legalizim. Ky bashkëpunim do të realizohet nëpërmjet kësaj marrëveshje që është firmosur dhe ju e keni përpara. Përfshirja e bashkive ka një rëndësi për faktin që jo vetëm do shtojë forcat për të mbështetur dhe zgjidhur problemin e legalizimit për shumë qytetar, por edhe do shërbejë për të bërë monitorimin e punës së Kadastrës. Bashkia duke qënë entitet më pranë qytetarëve, do të veprojë në rolin e kordinatorit, duke bashkërenduar planin e

punës me ASHK-në, duke priorizuar zonat, asistencë për qytetarët, plotësimin e dokumentacionit, vendosja në dispozicion e burimeve njerëzore. Afati i kësaj marrëveshje është 1 vit nga lidhja e saj dhe fond shtesë buxhet për këtë marrëveshje nuk ka, do bëhet me punonjësit e bashkisë. Fredi-cila është arsyeja që pas 7-8 vitesh znj.Kryetare në funksion, skishte nevojë për marrëveshje këtu, pse se ka bërë më përpara bashkëpunimin institucional, sepse i është premtuar banorëve që legalizimi duhej të kishte përfunduar. Delina-sepse duhej një rregullim ligjor, dhe ishte një funksion që i kishte kaluar ASHK-së, dhe aktualisht në VKM-në që është miratuar në datë 26.06.2024 i jep dhe këtë bashkëpunim bashkisë që të kordinojë punën me punonjësit që ka me ASHK-në për ta përmbyllur sa më shpejt procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje. Dhurata-aty janë 1500 aplikime, kërkesat e tyre deri tani nuk janë marr parasysh fare gjatë kësaj kohe? Delina-aq janë aktualisht në sistem. Dhurata-ishte domosdoshmëri patjetër për marrëveshjen e bashkëpunimit? Mua smë duket e drejtë, duke menduar që këtë funksion do ta kryejnë punonjësit që janë brenda bashkisë, sikurse ne folëm në mbledhjen e Kryetarëve të Grupeve, dhe atje u tha që do hiqen pjesërisht punëtorët që punojnë aktualisht në bashki dhe do merren me këtë proces. Kjo nuk është e drejtë të dypunësohen punëtorët brenda bashkisë, por ama të punësohen të tjerë, i bie sikur çalon çik puna. Është e drejtë që këta punëtor tu hiqet funksioni që kanë, të punojnë 4 orë këtu, e 4 orë në punë tjetër? Delina-përsa kohë që është bërë riorganizimi i punës brenda bashkisë, punonjësi po mund ta perballojë. Dhurata-po në kohën që vjen një individ në orën 2 dhe nuk e gjeti këtë punëtor, ku do ta gjej zgjidhjen ky ? Kryetarja-do ta gjej zgjidhjen. Amarildo-besoj se të gjithë qytetarët janë të informuar, kanë kaq vite dhe e dinë shumë mirë që qeveria u ka premtuar që do legalizohen banesat e tyre, që në fushatën e 2013 dhe sot e kësaj dite ata nuk kanë arritur dot që të marrin çertifikatën e pronësisë. Tani ju do bëni sërish një ping-pong duke i sorollatur qytetarët, sa në zyrat e bashkisë dhe sa në zyrat e Kadastrës, pasi ua garantoj që këtu nuk janë specialistët e duhur për të dhënë shpjegime, dhe ju nuk keni asnjë kompetencë, thjesht do bëni bashkëpunim, por do bëni një sorollatje plus për ata qytetarë. Ku mendoni ju se do ketë rezultat ky bashkëpunim i bashkisë dhe Kadastrës, kur duke qënë se ju keni kaq kohë, dhe ju e dini shumë mirë që këta nuk janë realisht ky numër, është shumë herë më i madh, dhe ju do ta shikoni në momentin që do filloni bashkëpunimin sesa të tjerë do vijnë të kërkojnë ndihmën tuaj, ndaj them që kjo nuk do ketë ndonjë sukses siç nuk ka patur deri më sot. Kryetarja e bashkisë- në vijim të gjithë pyetjeve dhe shqetësimeve që ngritët, sigurisht që shqetësimi është i drejtë, parë kjo në këndvështrimin e qytetarit, banorit por edhe të anëtarit të këshillit. Sipas gjithë informacioneve që ne kemi marr zyrtarisht nga ASHK-ja, dosje që janë në sistem, të aplikuara nga qytetarët vetëm për banesa, është 1593 aplikime, kryesisht njësia me numrin më të lartë është njësia e Strumit dhe Roskovec. Deri tani sipas ligjit institucion me të drejtë ligjore për të filluar procedurën e legalizimit dhe për ta përfunduar, dhe për të nxjerrë dokumentin është ASHK-ja, nuk është bashkia. Me ligj e ka ky institucion, është institucioni i parë ku qytetari përmes e Albania paraqitet për të bërë aplikimin dhe po përmes këtij sistemi, përmes gjithë procedurave që i kontrollojnë, i monitoronte deri më tani ASHK-ja, nxirrte dokumentin e pronësisë për çdo qytetar. Duke parë situatën jo vetëm në Roskovec por në gjithë Shqipërinë, që në fakt ka një problem me ne shqiptarët, që edhe pse afati i legalizimit ligjërisht ka mbaruar dhe nuk duhen bërë më aplikime, këto aplikime vazhdojnë, ndërtimet në territor edhe pse ka një kontroll më të mirë, monitorim më të mirë nga Policia Bashkiake, nga IMT-ja, përsëri qytetarët vazhdojnë ndërtojnë pa leje. Në këtë moment vjen këshilltari Zh.Metushi.Prezent 17 këshilltar. Kryetarja e bashkisë-edhe pse afati zyrtarisht ka qënë i mbyllur përsëri ka aplikime. Amarildo- në të gjithë Bashkinë Roskovec ndërtime sot nuk ka. Kryetari i Këshillit- z.këshilltar ju nuk ju ndërpreu njeri,

dhe të gjitha vërejtjet që ju mund të keni, mund ta kërkonti përsëri fjalën. Ju po tentoni të abuzoni dhe nuk është hera e parë që ju tërheq vëmendjen. Kryetarja e bashkisë- që ka ndërtime sigurisht që ka, se ne sot jemi duke penalizuar qytetarët me gjoba, edhe pse VKM-ja për ndërtimet sidomos në fshat, e ka lehtësuar shumë procedurat në marrjen e lejeve të ndërtimit për qytetarët, për ndërtimin e banesave, për shtesën e katit, mure rrethuese, për ndërtime që vijnë në ndihmë të bujqësisë, përsëri qytetarët vazhdojnë ndërtime pa leje, pa deklarata edhe pse ky vendim e ka lehtësuar shumë procedurën e dhënies së këtyre miratimeve. Duke parë këtë lloj situatë, këtë lloj ngarkesë dhe duke vlerësuar që bashkia është institucioni më pranë qytetarëve dhe në gjykimin tim asnjëherë nuk duhej ti ishte hequr bashkisë kjo gjë, qeveria shqiptare ndryshoi vendimin, na solli një vendim për zbatim, i cili na detyron që të lidhim këtë marrëveshje, pas miratimit në Këshill, për një bashkëpunim të shtuar me ASHK-në. Ky bashkëpunim mund të ishte në dy forma : ose të krijohet një nukël i ri duke i dhënë financim ASHK-së, ti transferonim buxhet dhe ky nukël të administrohej nga ASHK-ja, ose ne me punonjësit tanë, duke krijuar një nukël këtu, do bëhet organizimi i punës për gjithë aplikimet që janë në sistem, duke u prioritizuar se cila njësi dhe cili fshat ka sot nevojën më të madhe për të filluar punën në terren, bashkërendohet puna, duke mos i hequr asnjë nga detyrat që kanë si pjesë tjetër e detyrës funksionale që kanë punonjësit, duke organizuar punën në mënyrë të tillë që dhe puna tjetër të kryhet, ne do bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur verifikimet në terren, plotësimin e dosjeve për çfarë ato kanë nevojë, se jo të gjitha dosjet janë në një nivel. Pasi ne të bëjmë vlerësimin e çdo aplikimi, do të vijojë puna në terren e organizuar me disa grupe, dhe do përpiqemi që në kohën më të shpejtë të mundur ne të plotësojmë çfarë këto kanë, dhe duhet ti plotësojmë sipas kërkesave të ASHK-së, në mënyrë që në kohën më të shpejtë të mundur qytetarët të marrin dokumentin për shtëpinë e tyre. Pas kësaj marrëveshje bashkia merr autoritetin të bëjë verifikimin, të sistemojë saktë se çfarë mungon në dosje dhe ti japi shtysë këtij procesi në ASHK, por kompetencën ligjore për të nxjerrë dokumentin sigurisht që e ka ASHK-ja. Ajo që ne kemi gjykuar, gjithë vlerësimeve që kemi bërë, burimeve tona njerëzore që kemi, mënyrën sesi do ta organizojmë punën, gjykuam dhe sollëm para jush këtë draft marrëveshje, ku të mos shtojmë buxhet shtesë, skemi pse harxhojmë nga taksat tona lekë për të marr punonjës të rinj, ndërkohë që po ta organizojmë këtë punë në mënyrë më të mirë të mundshme, në një afat që ne do gjykojmë, besoj që do ta mbarojmë këtë punë shumë shpejt dhe pastaj do të jemi shtysa pranë ASHK-së që këto aplikime të përfundojnë dhe qytetarët të marrin lejen e legalizimit. Këtu nuk ka ngjyra politike, sepse në këto 1593 aplikime janë me të majtë me të djathtë, mund të jenë njerëz që skanë lidhje fare me politikën. Qytetarët duan lejen e legalizimit dhe kjo marrëveshje ka në thelb pikërisht këtë gjë, shërbimin ndaj qytetarëve për të marr këtë dokument. Dhurata- meqënëse Kryetarja tha që sdo ketë selektime, sa do rezultojë që sdo ketë selektime, sepse ju thatë që vazhdojnë ndërtimet pa leje dhe kjo është e vërtetë, të paktën për zonën ku banoj unë, sepse rezulton që ka familje që ka bërë ndërtime pa leje dhe ka marr gjobë, dhe ka familje të tjera që kanë bërë ndërtesa 2 katëshe dhe sjanë gjobitur fare, i kemi me fakte, ndaj nuk bindem unë që Kryetarja thote sdo jenë selektive, kështu uroj të jetë që të zgjidhen të gjithë. Kryetarja e bashkisë- vendimi i qeverisë i ka lehtësuar shumë procedurat për marrjen e lejes, sidomos në fshat, the një pretendim që nuk qëndron. Dhurata-qëndron se i kam me fakte. Kryetarja e bashkisë-ky është këndvështrimi juaj dhe nëse doni unë mbledhjen tjetër ju sjellë informacion sa qytetarë kanë aplikuar për leje ndërtimi, sa kanë marr deklarata paraprake për shtesë kati, për një ndërtim të ri, për mure rrethuese, dhe sa prej tyre janë penalizuar për gjobë. Ai që penalizohet për gjobë do të thotë që nuk e ka respektuar këtë institucion, ka filluar një ndërtim pa marr deklarata

për leje ndërtimi. Ndërsa qytetarët e tjerë që mund ta kenë ngritur katin e dytë, kanë ardhur këtu kanë marr një deklaratë sipas ligjit, me pagesë kundrejt bashkisë, sipas tarifave që ka vendosur ky Këshill. Të tjerë që kanë marr gjobë nuk e kanë respektuar institucionin dhe vendimet që janë miratuar në këtë Këshill. Informacionin ua sjellim mbledhjen tjetër. Amarildo- në lidhje me pjesën që u fol, i bie që Kadastra deri më sot ka qënë në gjumë, nuk e ka kryer funksionin e saj, sepse ju thoni që këto dosje që janë i bie që kanë mungesë dokumentacioni. Kadastra e ka detyrim ligjor tja kërkojë qytetarëve se çfarë ju duhet atyre, dokumenta të tjera shtesë për ti plotësuar në dosjen e tyre dhe për të marr atë çertifikatë pronësie. Deri më sot i bie që Kadastra ka pasur atë funksion që nuk ka lidhje për çfarë është krijuar. Çfarë do ndryshojë me ardhjen e bashkëpunimit me bashkinë në këto dosje, sepse sërish ata qytetarë do ti plotësojnë këto dokumenta, sdo i plotësojë bashkia. Në lidhje me atë që tha Kryetarja, janë bërë gjoba realisht, por sepse ligji ka qënë edhe për një gardh, dhe për një mur rrethues ata janë ndëshkuar, por leje ndërtimi nga 2013 dhe këtej janë shumë të kufizuara, dhe na sill në mbledhjen e radhës sesa leje ndërtimi keni dhënë nga 2013 e këtej. Keni dhënë thjesht për riparim çatish, mure rrethuese, gardhe por jo leje ndërtimi. Ato janë shumë të pakta, shumë të kufizuara, dhe nuk janë ndërtuar sot në territorin e Bashkisë Roskovec një numër i lartë ndërtimesh për banim, as për bizneset nuk ka ndonjë ndërtim të ri. Kryetari i Këshillit-pyetja juaj ngjan më shumë në formën e një diskutimi, dhe unë realisht nuk e kuptova se cila ishte pyetja. Amarildo-po e riformuloj, sa leje ndërtimi keni dhënë nga 2015 deri më sot? Kryetari i Këshillit-nëse ishit i vëmendshëm, Kryetarja i premtoi këshilltares që do ta japi këtë informacion, ju nuk mund të diskutoni për diçka e cila e ka marr një zgjidhje këtë mbledhje. Kryetari i Këshillit-do doja të falenderoja nga zemra iniciativën e qeverisë shqiptare dhe mbështetjen që ka gjetur ajo në Bashkinë Roskovec për ti mundësuar bashkëqytetarëve tanë, atyre njerëzve të thjeshtë që na kanë besuar detyrën që jemi sot, tju mundesoj më së fundi pajisjen me lejen e legalizimit. Është një proces shumë i rëndësishëm, unë nuk jam dot i zoti aq sa ju që të vlerësoj nëse ka qënë pamundësi, paaftësi e atyre që e kanë patur për ta bërë këtë detyrë deri tani, megjithëse një opinion e kam dhe është pikërisht ky, që institucionet kanë punuar, por volumi i kërkesave mua më duket shumë i madh, dhe në momentet e para kur është premtuar që do realizohet për një kohë të shkurtër, vet kam menduar që është një proces shumë i vështirë. Amarildo ndërhy. Kryetari i Këshillit-ju lutem sinqerisht mos më ndërprisni më sepse ju ndërprisni gjithkënd dhe flisni sa herë e shikoni të arsyeshme, ju lutem përmbajuni rregullores. Do doja të bëja dy pyetje duke parë me vëmendje këtë kontratë :1.Këtu në kontratë tek neni 6 kemi një pikë, pika ç që thotë : “bashkia të identifikojë fondin që mund ti transferohet nga ASHK-ja për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshje dhe të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për transferimin e fondit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshje”. Kjo do të thotë që punonjësit që do të punësohen, që do merren me këtë proces do të kenë dy varësi, dhe nga bashkia dhe nga ASHK-ja? 2.Në rregulloren e funksionimit të bashkisë punonjësit që do të ngarkohen me këto detyra, janë marr masa që të bëhet tek përshkrimi i punës së tyre dhe detyrat e reja që do të mbajnë gjatë kohës së ushtrimit të detyrave që tashmë i kanë, sipas rregullores aktuale? Kryetarja e bashkisë- pyetjet janë shumë të qarta dhe shumë të vlefshme për të qartësuar gjithë situatën. Variantet ishin në dy mënyra, ose në së bashku me ASHK-në të vlerësonim që për këto nevoja që ka sot Bashkia Roskovec, të vlerësonim sa punonjës duhen për një periudhë të caktuar për të bërë verifikime në terren, nëse biem dakort që duhen 5 punonjës shtesë, fondin e pagave për këta 5 punonjës ose tja transferonim ASHK-së dhe ASHK-ja ta ngrejë grupin, dhe ky grup të menaxhohet nga ASHK-ja, ose variantin që ne ju kemi ofruar, këta 5 punonjës me punonjës nga brenda ose dhe me ndonjë punonjës të ri që

ne mund të marrim shtesë nëse do jetë e nevojshme, ti dedikojmë për këtë punë, të organizojmë ne grupet dhe këta punonjës të varen totalisht nga bashkia. Jorgo-me fonde shtesë? Kryetarja e bashkisë-jo me fonde shtesë, brenda këtyre punonjësve, nëse do vlerësojmë që na duhet ndonjë shtesë, kemi akoma vakanca në strukturë që nuk janë ezauruar, dhe një nga ato vakanca mund ta transferojmë në këtë gjë, dhe nga eksperiencia ime une bashkë me grupin e punës gjykojë që më mirë të ngrejme këtë strukturë brenda bashkisë, të mos harxhojmë lekë, dhe këta punonjës më mirë e bëjnë duke rakorduar ne me njëri-tjetrin, sesa ti japim një fond ASHK-së dhe ASHK-ja të vazhdojë në të njëjtën rrjellë siç ka bërë deri tani. Ne gjykuam që kjo është më mirë kështu dhe do japi më shumë efekte, ne e njohim punën, edhe stafi i Bashkisë Roskovec jemi mësuar me njëri-tjetrin. Padyshim që në rregulloren e bashkisë, në detyrën funksionale që ka gjithsecili nga këta punonjës që do angazhohet edhe me këtë detyrë, patjetër që do rregullohet edhe kjo gjë e re që do marri, edhe orari i punës patjetër që do rregullohet, dhe nëse këta punonjës kanë ndonjë detyrë që mund ta kryej edhe ndonjë punonjës tjetër, patjetër që do ia transferojmë një punonjësi tjetër, në mënyrë që asgjë nga shërbimi që u jepet qytetarëve të mos ngelet pa u dhënë qytetarëve. Padyshim që këto janë marr në konsideratë, janë menduar nga ana jonë, dhe rregullorja me përshkrimin e punës patjetër që do ndryshojnë. Unë kam si objektiv vet, që ne brenda afatit që kemi të përcaktuar, ta bëjmë mirë këtë punë, dhe ky rast të mos jetë zhgënjyes, në mënyrë që këto aplikime që kanë ngelur aty të marrin zgjidhje, dhe të marrin fund. Kryetari i Këshillit-faleminderit znj.Kryetare, unë ju uroj shumë suksese në këtë detyrë shtesë që ju keni marr, sepse vet e çmoj si shumë të vlefshme në dobi të qytetarëve të bashkisë tonë. Dhurata-do ketë të tjera regjistrime veç këtyre që janë aktualisht? Kryetarja e bashkisë-kjo varet nga ndërtimet pa leje. Dhurata-po pse do ti stoponi tani? Kryetarja e bashkisë-prandaj vendosen penalitete, që qytetarët të kuptojnë që duhet të paraqitesh në institucion, të bësh një kërkesë për autorizim për deklaratë, për leje në rastet kur duhet leje dhe të kuptojnë se është më mirë që të marrësh atë deklaratë, dhe të bësh atë lloj ndërtimi, çfarëdo lloji qoftë ai, merr dokumentin dhe vazhdo punën i qetë, sesa të bësh një ndërtim pa leje për të cilin edhe merr gjobë, dhe pastaj nuk ke dot mundësinë ta legalizosh. Leksi-duke parë këtë marrëveshje, leja e legalizimit do dali këtu apo në ASHK, që të qartësohemi? Kryetarja e bashkisë- ligji për legalizimin në këtë pikë nuk ka ndryshuar, nuk e jep bashkia, vendimmarrjen sipas ligjit e ka ASHK-ja, ajo që bën bashkia është që atë aplikim që ka një sër dokumentash që duhen sipas ligjit, ne ti plotësojmë, ta lajmërojmë qytetarin, ta mbështesim dhe për të bërë aplikimin tek e Albania, se ndodh që ndonjëherë qytetari vetëm se sdi të bëj aplikimin tek e Albania ngec, ta marrim qytetarin, ta lajmërojmë me telefon, aty poshtë do ketë një sportel të dedikuar vetëm për legalizimet, punonjësi do ti marri në telefon qytetarët një e nga një. Pasi dosja të jetë mbyllur me gjithë kërkesat ligjore, do përcillet në ASHK me aplikimin e përfunduar, dhe do jemi ne si bashki që do raportojmë, që pas një muaji kemi përfunduar kaq dosje, dhe do ja çojmë këtë informacion ASHK-së qëndrore, që të dyja palët bashkë, ASHK-ja dhe bashkia do bëjnë presionin në kuptimin e mirë të fjalës pranë ASHK-së në Fier, që të dalin dokumentat. Leksi- u qartësova, normalisht mund të punohet këtu, por është problemi përderisa se kemi në dorë për legalizimin, mund të mbetet pjesa atje, mund të mos punojnë dhe ata, ti bëhet një tip presioni për mirë. Pegiola-mesa kuptova ASHK-ja deri tani nuk paska kryer asnjë lloj funksioni, dhe këta punonjësit e Kadastrës deri ditën e sotme nuk i kanë lajmëruar për plotësimin e dosjeve, për lajmërimin e njerëzve, po duhet sot për një kohë kaq të shkurtër 1 vit që është kontrata, dhe ne e dim pse bëhet ky 1 vit që është prag zgjedhjes, janë shumë gjëra të tjera, dhe Kryetarja pohon që nuk do jetë pjesë e tillë. Do bëhen dhe presione për mirë, që Kadastra të kryejë funksionin e punës dhe të vazhdojë menaxhimin dhe kordinimin

midis punonjësve të bashkisë, të cilët janë të punësuar por do merren me punët e Kadastrës, të cilat deri më sot nuk i paska bërë dot Kadastra dhe do i bëka sot. Nuk më pëlqen arsyetimi që ju zgjidhni dhe mënyra sesi e keni vendosur për një kohë kaq të shkurtër, dhe pse pikërisht për një kohe 1 vjeçare, dhe pse dalin këta punonjësit e Kadastrës sot si të paaftë, dhe duhet menaxhuar nga bashkia që këto leje të jepen më shpejtë, që mos të riaplikojnë, mos të gjobiten. Kryetari i Këshillit-pyetja ishte për Kryetaren apo për pjesën e Kadastrës? Kryetarja e bashkisë- këtu spo flasim as për politikë as për zgjedhje, dhe pëlqimi apo mos pëlqimi është sigurisht e drejta juaj, asnjëri nuk imponon këtu. Ajo çfarë unë shpreha, e shpreha shumë qartë, i gjithë procesi është në ndihmë të qytetarëve për të përmbyllur procesin e legalizimit për ato dosje të cilat kanë ngelur në sistem. Nëse ka punuar apo jo ASHK-ja ju pyesni ata qytetarë që janë pajisur me leje legalizimi, me certifikata pronësie, jo vetëm për shtëpi, por për biznese, për pronë. Këta punonjës të cilët përveç punës që kanë bërë deri tani, do lehtësohen pak nga puna që bëjnë në përditshmërinë e tyre dhe do bëjnë këtë detyrë për aq kohë sa është e nevojshme, që teknikisht në terren dhe në zyrë dosja të plotësohet me dokumentacionin e duhur për të përmbyllur procesin e legalizimit të të gjithë qytetarëve në territorin e Bashkisë Roskovec. Rezultatet këtu do jemi do ti shikojmë, në fund fare do jeni ju ata që do thoni faleminderit. Ermira- duke qënë se edhe në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit unë jam shprehur që e mbështes ngritjen e këtij grupi pune që do të merret me dhënien një dorë të plotësimin të dokumentacionit, dhe në fund me marrjen e legalizimit nga qytetarët, pasi mendoj që do tju vij shumë në ndihmë qytetarëve, do të doja shumë që edhe ne si Këshill të njihemi për çdo periudhë 3-mujore, informacionin që janë marr me kaq dosje, me kaq dosje është punuar, ku ka ngelur problemi, që edhe ne të kemi një njohje në vijimësi të punës së bërë nga grupi i punës. E kam me tepër si sugjerim, që edhe tek ne si Këshill të raportohet duke qënë se ne po e mbështesim këtë strukturë. Kryetari i Këshillit-vura re që tek kontrata ishte paraparë një shkëmbim informacioni për mbarëvajtjen e punëve midis dy institucioneve. Fredi-znj.Kryetare po të kishit qëllimin e mirë ju do ta kishit bërë, do kishit ndihmuar qoftë edhe për një dosje, keni pasur mundësi sa të duash. Mesa thatë ju kompetenca punonjësit e bashkisë nuk kanë, as të firmosin, as kompetencë ligjore, nuk kanë asnjë gjë. Kompetent për këtë punë, për këtë dokumentacion janë punonjësit e Kadastrës, ata kanë kompetencën dhe fondet përkatëse. Nëse doni ta shtoni me administratën, administratë më të fryrë se kjo nuk ka, sepse ngjysëm llafi thotë herën e parë Kryetarja, pastaj tjetër, me një fond, në fillim tha nuk do shtohet fond, pastaj tha do shtohet një, mund tja japim Kadastrës. Kryetarja e bashkisë-çfarë të ka ardhur ty për diskutim, çfarë i ke këto që po bën? Fredi-ka mundësi mos të më ndërhysh se unë mora leje, mos fol pa leje të lutem. Kryetarja e bashkisë-mua më vjen shumë keq që Kryetari të lejon që të thuash gënjeshtër, sepse unë në asnjë moment nuk thashë që do shtohet fondi. Fredi- z.Kryetar ka mundësi të më lejoni të flas? Unë si kam ndërhyrë njeriu, dhe sdua të më ndërhyjë njeri. Kryetarja e bashkisë-me gënjeshtër nuk mund të vazhdosh. Fredi-nëse ka gënjeshtër më thuaj çka kam gënjyer. Pasi të mbaroj unë fjalën më thuaj çka kam gënjyer, ka video këtu, kërkoj edhe falje në qoftë se gënjej. Administrata është 397 do ta çoj 400 çojeni, i shtuat dhe rrogat 1 milion e 400, 2 milion e 400 Kryetarja shtojini më, problemi është se këto janë taksa të qytetarëve or vëllezer, kjo është për zgjedhje, nuk është për asnjë gjë tjetër, për ti çuar të gjithë qytetarët që kanë dosje, ti biem këtu, që ti kërkojmë votën nën presion siç e tha vet Kryetarja, sepse e di ajo ka kompetencë, edhe unë qytetar kam një motër me aftësi të kufizuar atje në Ngjeqar, e bëri Kadastra pa jurist, pa asnjë gjë, ja dha certifikatën në dorë, edhe lejën e legalizimit pa ndihmën e bashkisë, pa ndihmën e specialistëve, pa fond shtesë. Ata të Kadastrës kanë marr fond nga qeveria qendrore, nuk presin ata

ti japim ne, kur ne skemi kompetenca, kur ne nuk kemi as të drejtë firme, asnjë gjë, kur sjapim as lejen për ç'a do ti çojmë? Është thjeshtë vetëm për politikë, për ti bërë presione dhe për ti kërkuar votën, jo për të bërë një kontratë, po të kishte mundësi e kishte bërë, edhe sot po të ketë mundësi me një telefonatë Kryetarja e bën dosjen, absolutisht po. Administrata është e fryrë jashtëzakonisht, nuk kam asgjë që mos të marrin ata dosjet, por më vjen keq për procedurën që ndiqet nga këtu, kur ne skemi asnjë kompetencë, kemi vetëm thjesht sekserin, ky është demokrat, ky është socialist, ky ka mbyllur kontratën me Kryetaren për të dhënë votën, ky smë ka dhënë votën, ne i kemi parë në praktikë këto punë. Kryetari i Këshillit- faleminderit z.Fredi dhe për pasionin më të cilin ju folët. Fredi-pasionin ti mos ma trego të lutem shumë, mua për atë më kanë votuar qytetarët të flas me pasion, unë e kam treguar veten as me abstenim, por me votë pro dhe kundër, nuk kam bërë dorëheqje siç bëni ju me pasionin tuaj. Kryetari i Këshillit- do doja shumë që tju kujtoja pyetjen që unë i bëra Kryetares së bashkisë dhe shprehimisht duke parë këtë pikë të kontratës që thotë të identifikojë fondin që mund të transferohet nga ASHK-ja bashkisë. Fredi-ne si Këshill nuk i kërkojmë dot ASHK-së të na japi fond, se skemi të drejtë ligjore. Kryetari i Këshillit- unë të dëgjova me vëmendje, ishte dashamirëse ajo fjalë që ju thashë, por ju e morët në mënyrën që e morët. Po ju them e keni të shënuar në kontratë, dhe ajo që kërkohet në bazë të kontratës është që bashkia të identifikojë fondin që mund ti transferohet nga ASHK-ja, dhe këtu nuk kemi diskutuar që nga bashkia do ti kalojmë fond ASHK-së. Fredi-sa e tha Kryetarja, hape vidion, ose punonjësit e bashkisë do marrin një shpërblim të caktuar tha. Kryetarja e bashkisë-nese keni pyetje dhe diskutime të tjera përmbledhimi të gjitha, se nuk ka kuptim që ti përsërisim të gjitha njëri pas tjetrit, kur të gjitha kanë vetëm një qëllim, nuk mund të rrimë që tu kthehemi gjithmonë këtyre gjërave. Gjithsecili nga ju ka të drejtën e vet që të flasi, por është më mirë ti përmbledhim dhe ta sqarojme gjithë situatën me një diskutim të vetëm. Të kërkoj ndjesë për ndërprerjen por mora shkas nga mënyra sesi fole, këtu flasim dhe kemi të drejtë të diskutojmë, gjithsecili ka mendimin e vet, asnjëri nuk ta heq të drejtën e fjalës, as të asaj që mendon ti dhe shpreh, është e drejta jote, por që të gënjesh dhe të abuzosh kjo nuk shkon. Fredi-absolutisht, në qoftë se kam gënjyer unë kerkoj falje, hape vidion. Kryetarja e bashkisë- në asnjë moment unë nuk thashë që ju kam sjellë një marrëveshje dhe kërkoj fond për tja kaluar ASHK-së, unë thashë që kishte dy mënyra të propozuara nga qeveria që iu propozuan bashkive, dhe bashkitë kishin të drejtë të zgjidhnin për tua propozuar Këshillit. Mënyra e parë ishte që ne në bazë të llogaritjes të numrit të punonjësve që duheshin, të miratonim fondin bashkë dhe tja transferonim ASHK-së. ASHK-ja të ngrinte nuklin dhe numrin e punonjësve dhe gjithçka, ta menaxhonte ajo këtë gjë kam shprehur. Kjo ishte mënyra e parë që fondin tua jepnim ne. Mënyra tjetër ishte që ne, bashkia jonë të zgjidhte vet punonjësit, ta organizonte nuklin vet dhe me këta punonjës të ndarë sipas detyrave, ti ngarkojë detyra shtesë, duke i lehtësuar pak nga detyra që kanë, dhe kjo punë do bëhet nga punonjësit e bashkisë. Këtë të dytin kemi zgjedhur ne, dhe ua kam sjellë juve për propozim, pra që ne si bashki të mos harxhojmë lekë të tjera, të mos i japim lekë ASHK-së, por me punonjësit tanë, me ata që e njohin këtë gjë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, edhe thashë nëse do duhet ndonjë tjetër shtesë, do shikojmë nga pozicionet që kemi në strukturë, pa shtuar numër. Fredi- spaskam gënjyer unë. Kryetarja e bashkisë- ke gënjyer dhe totalisht, 100% ke gënjyer dhe këtë ti e bën për qëllimet e tua, por nuk mund ta bësh dot, të lutem politikën lëre përjashta, këtu jemi për tjetër gjë, dhe thuaj fjalë për fjalë çfarë unë kam sjellë, dokumentat janë këtu, ju kam sjellë një propozim për një marrëveshje që punonjës të bashkisë pa shtuar fond shtesë, ne të ngrejmë këtë nukël për të marr gjithë kohën e duhur për të verifikuar çfarë duhet në terren, prej një afat 3-6 muaj fazën e parë, në mënyrë që ne të

përmbushim çdo lloj kërkese që ato aplikime kanë të papërmbushura në dosjet e tyre, për ti ndihmuar qytetarët. ASHK-ja sa mirë paska vepruar me atë motrën tënde, ja që paska punuar ASHK-ja, dhe shumë mirë që e ka marr, dhe si motra juaj ka dhe shumë qytetarë të tjerë që e kanë marr shërbimin nga ASHK-ja. E gjithë kjo bëhet në mënyrë që qytetarët e mbetur, të përshpejtohet procedura, që ti marrin sa më shpejtë. Sa për administratën nuk është 397 por është 120 e ca, nëse flet për administratën publike flet për nënpunësit civil, nëse flet për punëtorët që pastrojnë rrugët, ata janë punëtor që pastrojnë rrugën, që pastrojnë dhe trotuarin tënd, që përgjigjen edhe për ndriçimin tek shtëpia jote, dhe të gjithë së bashku duke minimizuar kostot e këtyre taksave që paguan qytetari, në përpikemi çdo vit që të shtojmë shërbimet ndaj qytetarëve. Pra në thelb mos gënje kur flet. Fredi-mos e përdor këtë se nuk kam gënjyer unë, sapo e pohove me gojën tënde. Kryetarja e bashkisë-të lutem shumë mos më ndërprit, kjo është marrëveshja, merreni shikojeni, lexojeni dhe nuk bëhet fjalë për fond që ti japim në ASHK-së. Nëse këtu brenda ka ndonjë hapsirë si ajo që tha edhe Kryetari i Këshillit, që ASHK-ja të mund të na japi në fond për ta përmirësuar këtë, lër të na japi dhe hajt ta kërkojmë, ndërsa në asnjë lekë ASHK-së, në këtë punë do ta bëjmë me punonjësit tanë, me këta që kemi dhe do ta përmbushim në një kohë sa më të shkurtër që qytetarët të marrin shërbimin e munguar deri tani. Amarildo kërkon fjalën. Kryetari i Këshillit-e keni marr pamjaftueshmërisht fjalën dhe e keni ezauruar, fjala nuk mund të jetë më për ju, ju nuk mund të abuzoni me atë gjë që thuhet këtu dhe ta deformoni. Amarildo-mos e politizo çështjen tani. Kryetari i Këshillit-ju po e politizoni, a mban evidencë sa herë e ke marr fjalën? Amarildo-sa herë të kem dëshirë. Kryetari i Këshillit-por duhet ti referohesh rregullores. Amarildo-po rregullores, a po të kërkoj fjalën për diskutim? Kryetari i Këshillit-mund ta marri ndonjë nga kolegët e tu që se ka marr fjalën. Amarildo-e keni marr pafundësisht fjalën ju,jo ne. Kryetari i Këshillit-për këtë pikë të rendit të ditës e ke marr të drejtën e fjalës mjaftueshëm. Amarildo-do ta marr sërish sa herë të jetë e nevojshme. Kryetari i Këshillit-ju lutem fjala nuk mund të jetë për ju, fjala është për z.Jorgo. Amarildo-e ke shumë gabim, e kam unë fjalën, sepse e ke bërë rrugë. Debat në sallë midis Amarildos dhe Kryetarit. Jorgo-në qofte se do ti zgjasim polemikat i zgjasim, por nuk është e mira, anëtar i këshillit ka të drejtë të marri fjalën sa herë e shikon të arsyeshme, të bëj pyetje jo ti ndërpritet fjala. Kryetari i Këshillit-në bazë të rregullores Kryetarja e bashkisë ka të drejtë ta marri fjalën sa herë e shikon të arsyeshme, këshilltari e merr një herë fjalën për pyetje dhe një herë për diskutime. Jorgo-polemika nuk është e mirë, në qoftë se do i bëjmë presion njërit apo tjetrit, më mirë mos të vijmë më këtu, nëse do diskutojmë për këto gjëra hajt diskutojmë, por polemika ulu ti ngrihu ti sikur nuk ja vlen. Amarildo-nuk na diktoni dot në fjalën dhe mendimet. Kryetari i Këshillit-referuar rregullores vetëm Kryetarja mund ta marri fjalën sa herë e shikon të arsyeshme, këshilltari mund ta marri fjalën një herë për pyetje dhe një herë për diskutim. Jorgo-edhe kur u përmendet emri ka të drejtë për replikë, ulni nervat dhe diskutojmë, mos ta prishim këtë mbledhje. Kryetari i Këshillit-keni të drejtë por nuk dëgjova ndonjë përmendje emri. Amarildo-e kam kërkuar fjalën brenda rregullores dhe është e disata herë që kërkoni të ofendoni këshilltarët e djathtë në këtë sallë, e keni shumë gabim që shfrytëzoni postin atje si Kryetar, dhe të na përmendni dhe të na thonë po përdorni fjalë rruge, jo fjalor rruge keni përdorur ju me Fredin duke krijuar epitete të kota. Do të lutesha shumë më jep fjalën brenda rregullores siç e kam kërkuar, kam bërë pyetje por jo diskutim. Kryetari i Këshillit-fjalën e keni ezauruar më shumë sesa dy herë për të njëjtën pikë të rendit të ditës. Fredi- Amarildo e ka marr fjalën dy herë për pyetje, për diskutim nuk e ka marr fjalën, dhe ka të drejtë ta marri fjalën për diskutim. Do më falesh ti jap përgjigje Kryetares për atë që më tha? Kryetari i Këshillit-prit sepse ju kështu po e merrni fjalën në mënyrë

abuzive, pasi z.Elmaz e ka kërkuar disa herë fjalën për pyetje, dhe ju nuk po më lejoni që kjo mbledhje të zhvillohet rregullisht, por meqënëse z.Amarildo mendon se do ta marri tani fjalën, duhet ta marri tani se mendon ai. Amarildo- a të kam bërë dy pyetje, tani kërkoj fjalën për diskutim, çka mendoj unë? Ta kam kërkuar me leje, a kam folur pa leje?Tani do më ndalosh të drejtën e fjalës spo e kuptoj, do na diktoni çka do themi ne? Kryetari i Këshillit- të drejtën e fjalës nuk ta ndalojë dhe as ta jap unë, ta jep rregullorja, ju lutem duhet ta zbatojmë. Z.Elmaz ka kërkuar fjalën. Amarildo- e kam kërkuar unë fjalën, e ka pas meje Elmazi, pasi të mbarojë unë. Kryetari i Këshillit-këtë sallë nuk e uzurponi dot ju. Amarildo-ti po bën zhurmuesin, ti po kërkon të bësh politikë, ju po e uzurponi. Në sallë ka zhurmë dhe debate nga këshilltarët të cilët po flasin njëkohësisht. Amarildo-vazhdoni vet nëse dëshironi kështu, siç keni bërë deri dje duke mos patur opozitë dhe pyetje, ndaj ju duket sot hidhur kur bëhen pyetje, sepse i keni kaluar të gjitha vet, ska pasur asnjë të bëj opozitën këtu, jeni tallur keni bërë çka keni dashur, prandaj ju duket sot çka po ndodh se po bëjmë pyetje. Do pyes sa herë të jetë e nevojshme. Kryetari i Këshillit i jep fjalën Amarildos. Amarildo- është e disata herë që na provokon, zbatu rregulloren asgjë më shumë. Në lidhje me atë që foli Kryetarja, e cila përmendi gjatë fjalës saj që kjo nuk është politike dhe nuk do kërkojë fonde shtesë për procesin e legalizimeve, unë do isha dakort edhe të kërkonin fonde shtesë, edhe të japim si bashki nuk jam kundër kësaj, për ti marr ato çertifikata ata qytetar, sepse është një gjë e mirë, kanë kaq vite që sorollaten, dhe të shtohet dhe organika me specialistët e duhur në qoftë se ata vërtet do jenë për ta bërë këtë punë siç duhet dhe jo të bëjnë selektime siç do ta shikojmë dhe do ta tregojë koha. Kjo është kryekëput politike, sepse sot kujtohen qeveria dhe bashkitë një vit para zgjedhjeve për të bërë këtë proces, kjo qeveri ka 12 vjet në pushtet dhe deri më sot çfarë ka bërë? Do ta realizoni brenda këtij viti që janë zgjedhjet, siç e dimë praktikën, duke i thirrur një e nga një këta qytetar, duke i bërë presion dosjet për të dhënë votën, dhe në rast të kundërt nuk ke për të marr legalizimet, kjo ka për të ndodhur. Kaq kisha unë Kryetar, ti e teprove dhe e zgjate kot me mua. Elmazi-ne jemi këtu për të ngritur problemet pa u revoltuar me njëri-tjetrin sepse jemi të gjithë për një qëllim, që tu shërbejmë më mirë qytetarëve. Nëse qeveria e ka nxjerrë këtë vendim, e ka nxjerrë për qytetarët dhe jo për politikë. Shpjegohet mire aty në dokument që nga bashkia nuk ka fond, ku është këtu politika dhe pse duhet ti ndajë Kryetarja e bashkisë kush janë të majtë kush janë të djathtë, pse mendohet dhe paragjykohet para kohe, le tja lëm kohës, bashkë këtu jemi, bashkë do ti gjykojmë dhe bashkë do kërkojmë më të mirën. Ne jemi të gjithë bashkëfshatar, mbi të gjitha jemi njerëz por jo të fyejmë njëri-tjetrin. Si Kryetar Grupi kërkoj ta hedhesh në votë, grupi ynë ka vendosur që ta kalojë. Lexi-meqënëse u krijuan polemika, unë kërkoj që kur të bëni mbledhjen e Kryesisë, futeni edhe një herë rregulloren, të sqarohet mirë rregullorja këtu si funksionon ky Këshill, sa herë kemi të drejtë të marrim fjalën, të bëjmë pyetje. Pra të qartësohemi të gjithë dhe mos ti futemi njëri-tjetrit në diskutim. Kryetari i Këshillit-do të njoftoheni me imail për këtë pjesë të rregullores. Fredi-unë jam munduar këtu në Këshill të ruaj etikën, në qoftë se unë gënjej ja ku janë të gjithë këshilltarët dëshmitar këtu, në qoftë se unë kam ofenduar, nuk kam ruajtur etikën, kërkoj të merren masa nga këshilltarët jo nga Kryetarja. Kryetarja ka ardhur me gjithë arrogancën e saj, kërkon të më fyej, ishin këtu të gjithë që ajo më tha gënjeshtar. Znj.Kryetare meqë e ktheve personale, unë edhe në punën time private, edhe në politikë jam munduar të mos gënjej, dhe kur gënjej me sinqeritet ju them kërkoj falje, nuk kam turp të kërkoj falje. Sapo mbarova Kryetarja tha atë që thashë unë por në mënyrën e saj, Kryetarja kërkon të më acaroj, kërkon për llafollogji sepse është live. Unë z.Kryetar kërkoj të ruhet etika dhe Kryetares, sepse është bërë shkak gjithmonë që prishet mbledhja. Unë jam munduar që mos të marr fjalën pa

leje, por prej gjaku jemi të gjithë. Unë e kthej dhe personale se kam fare problem por mos të na prishet mbledhja. Kryetarja e bashkisë-i nderuar këshilltar në asnjë moment të fjalës time nuk ju kam fyer juve apo të tjerë, dhe po të doni hapini shikojini se janë të regjistruara. Çfarë thua mbaji për vete, nuk kam asgjë personale as me ju as me asnjërin, por unë nuk ju lejoj as juve asnjë tjetër këtu, në cilësinë e Kryetares për atë që unë them, për atë që unë deklaroj dhe për atë që unë sjellë me shkrim, që ju të thoni gënjeshtër në fjalën tuaj. Jo që nuk ju kam thënë asnjë gënjeshtër por gjithçka e keni të shkruar çfarë ju vjen me shkrim. Jo këtë mbledhje por asnjë mbledhje as kam prishur as dua që të prish, por në qoftë se ju debatet dhe kundërshtimet i shikoni në këndvështrimin e prishjes së mbledhjes, kjo mbetet tek ju jo tek unë. Ne debate do bëjmë, kundërshtime patjetër që do kemi por kundërshtime me argumenta jo kundërshtime për atë që doni të thoni ju, për të përdorur faktin që mbledhja është online, për të thënë atë që doni ju të thoni, kjo është përgjegjësia juaj. Çdo fjalë e nxjerrë nga goja ime është përgjegjësi e imja, dhe çdo fjalë e nxjerrë nga goja juaj është përgjegjësi e juaja. Jo ju por askënd as kam të drejtë, as moral ta fyej, do doja që ky debat të mbyllej këtu. Fredi-unë se kam problem fare, por sapo më fyeve, unë të durova sepse jemi në mbledhjen e Këshillit, unë sjam vetvetja këtu jam zëri i qytetarëve, është hera e fundit z.Kryetar që unë e lejoj të më ndërpresin mua fjalën, jo ajo por asnjë, dhe të fyej këshilltarët. Të lutem bëni detyrën për atë që jeni votuar. Kryetari i Këshillit-faleminderit që ma kujtuat. A mundeni ju lutem që projekt-vendimin ta hapni në nenin 6 të kontratës? Fredi-unë e kam memorjen shumë të fortë, jo atë që përmend ti këtu, e kam memorjen shume të fortë çfarë më ke thënë kur kemi pirë kafe bashkë pas dorëheqjes si nënkryetar i bashkisë. Unë jam ai që jam, ai që do mbetem. As gënjej, as ngacmoj njeri dhe as nuk dua të më ngacmojë njeri. Kryetari i Këshillit-nuk ishte për të ngacmuar.Fredi-unë jam ky që jam,prandaj jam votuar nga qytetarët,kam marr 839 vota. Ska më diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin dhe miratohet me 11 vota pro, 6 vota abstenim nga koalicioni BF. Grupi i djathtë kërkon 5 minuta pushim. Pas pushimit rifillon përsëri mbledhja. Janë larguar nga mbledhja F.Feleqi, A.Hoxha, P.Toro. Prezent 14 anëtar në sallë. Kryetari i Këshillit-vazhdojmë me rendin e ditës.

6.Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.

Kryetari i Këshillit-vazhdojmë të nderuar këshilltar me pikën 6 dhe 7 të rendit të ditës, projekt-vendime të cilat kanë një lidhje organike me njëra-tjetrën. Relativimin për të dyja këto çështje, duke qënë se janë dy projekt-vendime që kanë një lidhje organike me njëra-tjetrën, fillimisht do të miratojmë projekt-vendimin Nr.6 sa i takon miratimit të fondeve shtesë në buxhetin e bashkisë Roskovec, në një objektiv të caktuar që është ndryshimi i nivelit të pagave, për shkak se të dy këto projekt-vendime kanë lidhje organike me njëra-tjetrën, relativimi i tyre do bëhet njëkohësisht dhe votimi i tyre veç e veç sipas rendit të ditës që ne kemi miratuar, fillimisht projekt-vendimi Nr.6 dhe më pas 7. Selmani-ky projekt-vendim ka të bëjë me akordimin e fondit në formën e grandit të pakushtëzuar për rritjen e pagave në bazë të vendimit të qeverisë, si dhe në bazë të shkresës së ardhur. Dhurata-meqënëse ne i kemi lexuar materjalet, mund ta kalojmë në votim? Elmazi-materjalet të gjithë i kemi para, dhe ma merr mëndja që janë njohur me të gjitha, prandaj unë jam i mendimit që grupi vendosi që ne ta kalojmë. Lexi-kemi disa paga këtu që janë në 3 nivele 47,60,70. Kjo tani si do vlerësohet, se unë për mendimin tim jam që të gjithë të marrin pagën maksimale, meqënëse ky fond ka ardhur. Delina-kategorizimi i pagës bëhet në momentin që bëhet vendimi i Kryetarit për nivelin e pagave, pasi miratohet këtu në Këshill. Kategoritë janë dy sipas

ligjit 4.3 dhe 4.4 dhe niveli i pagave për secilin kategori është 70,60. Kategorizimi për specialistët ndodh sipas asaj që unë ju thashë, në bazë të pozicionit të punës, rëndësisë së pozicionit, ngarkesës së punës dhe diplomës. Kryetarja e bashkisë- paga 47 është me shkollë të mesme, një njeri që ka mbaruar baçelorin merr 60 mijë lekë, dhe një që ka mbaruar masterin merr 70 mijë lekë. Leksi-jepi maksimalen dhe jemi në rregull të gjithë. Kryetari i Këshillit-ky fond që i është dërguar bashkisë Roskovec ka paraparë që të gjitha pagat të shkojnë në nivelin maksimal? Selmani-po, sepse këtë fond po ndajmë, ai fond sa ka ardhur këtë po ndajmë, dhe ky ka ardhur në bazë të organikës. Kryetarja e bashkisë-fondi që erdhi nga qeveria mbulon në mënyrë të plotë nivelin e pagës maksimale për të gjithë punonjësit në strukturën e bashkisë dhe ndërmarrjeve. Në këtë rritje page nuk përfitojnë punonjësit që janë jashtë administratës. Ky fond ishte i mjaftueshëm që të mbulojë nivelin maksimal për punonjësit e administratës të bashkisë dhe ndërmarrjeve. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 13 vota pro, 1 votë abstenim A.Pelo.

7. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.108 datë 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjeve vartëse, për vitin 2024”.

Kryetari i Këshillit-besoj se brenda relatimit më sipër janë ezauruar edhe pyetjet për këtë projekt-vendim. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 13 vota pro, 1 votë abstenim A.Pelo.

8.Për miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA 2025-2027.

Selmani-ky dokument është para fillimit të punës për miratimin e buxhetit të vitit 2025, i cili është dhe viti i parë i PBA-së 2025-2027. Ky dokument është voluminoz por që nuk ka ndryshime nga dokumenti i parë që ne kemi miratuar në Qershor. Ndryshimet që ne kemi marr në Gusht apo në Shtator do të paraqiten në dokumentin përfundimtar i cili do paraqitet gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor të këtij viti. Kryetari i Këshillit-dua ti bëj një kërkesë drejtorit, duke parë që ky është një materjal voluminoz, unë do doja që në relacionin që i vjen anëtarëve të Këshillit, në mënyrë të përmbledhur ndryshimet nga një dokument që ne kemi miratuar në mbledhjen paraardhëse në tjetrën, besoj se do na vij në ndihmë të gjithëve, për të gjykuar se çfarë ndodh brenda atij dokumenti të madh, për ta shqyrtuar. Dhurata-në faqen 2 janë projektet e investimeve, tek rrjeti rrugor rural, zgjerimi i rrugës Jagodinë-Suk1-Strum, data e fillimit 01.01.2024, mbarimi 31.12.2024. Buxheti është i planifikuar për në 2024, tani kjo ka mbaruar, çka do të thotë kjo pjesa, pse duhet të përfshihet ndërkohë që këto projekte kanë mbaruar? Rikonstruksioni i rrugës Malkaj fshati Suk 1, dhe kjo ka një datë fillimi dhe mbarimi, ka një kosto, por disa nga këto projekte kanë mbaruar, të tjerat skanë filluar ende. Nëse ndalemi tek asfaltimi i rrugës para shkollës Suk 1 që sapo është bërë tani, nga ana tjetër do bëhej dhe kanali, nuk e di ka përfunduar apo jo, është bërë një pjesë e mirë e punimeve, janë bërë dhe ca rrugë të tjera atje, që janë bërë me selektive. Kryetarja ka deklaruar në takimet që ka bërë me banorët, që do bëj atë rrugë që unë kam dëshirë të bëj, të tjerat nuk do bëhen, unë e dua një përgjigje. Këshilltari A.Pelo largohet. Prezent 13 këshilltarë. Selmani-sa i takon investimeve të cilat kanë filluar në vitin 2023 dhe akoma ne i paraqesim në këtë dokument, në bazë të sistemit që ne kemi në PBA, duhet që normalisht kur nuk

janë financuar plotësisht, duhet ti pasqyrojmë në sistem, pra si investime në vazhdim dhe investimet e reja duhet të hidhen në sistem. Në 2025 janë investimet e reja që kanë filluar, që janë në këtë vit dhe do të vazhdojnë në vitet e tjera siç ne i kemi miratuar, dhe vazhdojnë të jenë deri sa të përfundojnë. Dhurata-tek shkolla 9-vjeçare “5 Dëshmorët” ajo mbaroi. Selmani-po ishte financim edhe për këtë vit. Dhurata-po su bë asgjë. Selmani-Ministria e kishte planifikuar dhe për 2024. Dhurata-ja të na japi përgjigje Kryetarja. Kryetarja e bashkisë-do përgjigjet drejtori ekonomik, pyetja ishte për PBA-në, unë nuk jam specialiste. Dokumenti është shumë specifik financiar, unë nuk e njoh dokumentin kështu që drejtori i financave mund tju japi një përgjigje shumë më të qartë sesa unë për këtë gjë. Selmani-deri në kohën që nuk ka përfunduar likuidimi total i objektit, do të qëndrojë këtu deri sa të përfundojë financimi i tyre. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 2 vota kundër Dh.Malka,J.Begaj.

9.Për ndryshimin e emërimit të disa rrugëve në Bashkinë Roskovec.

Eldisoni-siç e kemi diskutuar në mbledhjet e kaluara, ky është një proces në vazhdimësi, dhe përmirësimi i adresave është një prej kushteve që kërkon procedurë. Në bashkinë Roskovec janë paraqitur disa kërkesa për propozim të emërimit të rrugëve dhe nga diskutimet e kryera nga takimet publike, dhe në bazë të mbledhjes me kryetarët e fshatrave, u morën në shqyrtim të gjitha propozimet, të cilat ja u paraqesim si më poshtë : Në njësinë Roskovec rruga me emërtimin e përgjithshëm Fotografi do ndryshohet me emërtimin rruga Azis Çepele. Dhurata-këto materjale ne i kemi lexuar, flas në emrin tim personal. Elmazi-tek emërtimi i rrugëve, u vihet njerëzve të cilët janë larguar nga kjo jetë apo u vihet dhe qytetarëve që janë gjallë? Kryetarja e bashkisë-ligji nuk ka përcaktim ose kufizim, e lë të hapur këtë gjë. Përderisa nuk ka përcaktime, e le të hapur, që në bazë të propozimeve të ndryshme si nga organizata, kryetar fshatrash, grupe interesi të ndryshme, vijnë propozime,merren në shqyrtim, nëse shumica e gjykon që po është njeri që e meriton këtë gjë, sillat këtu për miratim. Leksi- edhe në mbledhjen më parë kam kërkuar, se kanë kaluar shumë emra rrugësh, për vendosjen e tabelave që të përjetësohen dhe në tabela, sepse mesa kemi pyetur ata kanë paguar dhe një vlerë prej 8 mijë lekë të rinj për vendosjen e tabelave. Është vendosur një tabelë rruga Qemal Yzeiri që e kemi kaluar ne, diku tek kryqezimi tek rotondoja “Vajza Myzeqare”, rruga e Kumanit e ka një drejtim tutje, kurse kjo e ka këtë, duhet parë sepse është çorientuese nuk është orientuese. Kryetarja e bashkisë-unë dua tju sqarojë të gjithë, deri në këtë moment ne nuk kemi një fond nga qeveria të dedikuar, as nga bashkia për emërtimin e rrugëve. Ne kemi zgjedhur një mënyrë morale me të gjithë ata që u miratohet emri, me dëshirën dhe vullnetin e tyre, e prodhojnë tabelën vet atje ku prodhohet, dhe pastaj bashkia me punëtorët e vet e vendos sipas standartit që duhet. Është konsensus i familjarëve. Ne kemi bërë takim me kryetarët e fshatrave dhe me administratorët dhe do përpiqemi që ta shtyjmë këtë proces, që të nxiten të gjithë familjarët në vite, jo vetëm për ato që kemi bërë tani, të njoftohen për emërtimet e rrugëve, ta prodhojnë tabelën dhe ne ta vendosim. Mënyra standarte e vendosjes së tabelave është që emërtimi i tabelës të jetë sipas drejtimit të rrugës. Si duket asaj tabelës do ti jetë ndryshuar drejtimi padashje, me të drejtë duhet rregulluar, duhet të jetë paralel me rrugën. Vërejtja është e drejtë, do përpiqemi ta rregullojmë sa më shpejt. Dhurata-pse ska fond për këto, kudo kështu funksionon? Kryetarja e bashkisë- në qoftë se ne si Këshill bashkie do bëjmë një llogaritje preventiv, për të bërë të gjitha këto duhen kaq lekë, dhe hajde ta miratojmë këtë gjë, sigurisht që kjo është e arritshme. Por do

heqim dorë nga një investim tjetër. Ne kemi gjykuar këtë lloj modeli, që vet familjarët ta prodhojnë se nuk është ndonjë kosto e madhe, e kam bërë për moral këtë gjë, edhe ta vendosim. Ne do bëjmë bilanc, do ua sjellim edhe për propozim, por duke dashur që ne kemi prioritizuar që të zgjidhim ca kërkesa të tjera që janë më të nevojshme, ne skemi rrugë akoma i kemi me çakull, pra do bëjmë rrugë me asfalt apo do vendosim emërtimin e tabelës? Janë dy gjëra që po ti vendosesh në peshore, nevoja e qytetarëve është që më mirë të bëjmë rrugën dhe ndriçimin që mungon, apo të vendosim emërtimet e rrugëve? Ne kemi prioritizuar që tju sjellim për miratim sa më shumë investime aty ku janë më të nevojshme. Deri tani nuk kemi marr asnjë vendim për miratim të një fondi të posaçëm për prodhimin e tabelave. Leksi-të bëjnë një preventiv ta shikojmë dhe ne në Këshill, se sdo jetë sa kostoja e një rruge. Kryetarja e bashkisë-të gjitha së bashku e kalojnë koston e rrugës. Dhurata-po mirë, po pse organizoni festa ju pastaj, se dhe ato të bukura janë..Kryetarja e bashkisë-po sepse dhe festat kane rëndësinë e vet. Dhurata-por edhe këto janë të rëndësishme. Kryetarja e bashkisë-sigurisht janë të gjitha të rëndësishme, por nuk mund të heqësh dorë nga një që është krijuar një traditë, megjithatë ky është vlerësimi që kemi bërë. Dhurata-unë kisha një korigjim të vogël në lidhje me ato kritere që janë bërë aty, janë vendosur pikat kryesore që përzgjidhen për këto arsye, midis të tjerash një person që unë e njoh, nuk ka ndërruar jetë çështë e vërteta, është person shumë i njohur në publik, dhe shumë i nderuar dhe i respektuar. Unë spo i përmend emrin ska rëndësi, por si padashje është shkruar atje. Kryetari i Këshillit-marr shkas dhe nga diskutimi që bëri z.Elmaz, referuar pjesës së fundit të projekt-vendimit e cila thotë: emrat e propozuar për emërtimin e rrugëve plotësojnë kriteret ligjore për emërtimin e një rruge sepse : emrat e propozuar janë personalitete të dëgjuar në komunitet, personat kanë ndërruar jetë. Kjo pikë mbase duhet redaktuar në mënyrë që të përfshijmë edhe personat, mos të lëm vend për diskutim të kësaj. Patjetër që nuk ka kufizim dhe është ligjore të vendoset emri, por propozojë që mund të riformulohet. Kryetarja e bashkisë-po lexoj ekzaktësisht atë që keni edhe ju : emrat e propozuar për miratimin e rrugëve plotësojnë kriteret ligjore për emërtimin e një rruge sepse : 1.emrat e propozuar janë personalitete, kur themi janë do të thotë që janë në jetë. Tjetra kanë ndërruar jetë, disa. Nëse do thonim të gjithë kanë ndërruar jetë do kishit të drejtë, ne nuk e kemi thënë ashtu. Elmazi-këta njerëz që janë vënë nëpër këto rrugë, është marr pëlqimi i individëve apo familjarëve të tyre, ka dokumentacion? Kryetarja e bashkisë-patjetër. Kryetari i Këshillit-unë mendoj që kjo pjesë duhet redaktuar, ose ligji parashikon që edhe personat që nuk kanë ndërruar jetë mund të marrin emrin e një rruge dhe duhet minimalisht të shënohet që emrat e propozuar për miratimin e rrugëve plotësojnë kriteret ligjore për emërtimin e një rruge sepse janë : dhe mund të jetë 1 nga 3 rastet e mëposhtëme. Në qoftë se nuk kemi fjalën “janë” më sipër atëherë i bie që dashje padashje pranojmë një fakt të cilin nuk e kemi të vërtetë. Kryetarja e bashkisë-nuk na prish punë, e përmirësojmë për të qënë edhe më të qartë. Kryetari i Këshillit-po marr shembullin e Njësisë Administrative Kurjan, rruga me emëtimin Rrapo Kuka në fshatin Kurjan të ndryshohet me emërtimin rruga Shamet Faria. Tani çfarë ndodh, këtu ndryshon emri i rrugës, sepse në mënyrën sesi ka ardhur i shkruar ky projekt-vendim lihet përshtypje se ndryshohet emërtimi pikërisht rruga Shamet Faria. Eldisoni-rruga me emërtimin aktual Rrapo Kuka është rruga nga kryqëzimi i fillimit të fshatit Kurjan, vazhdon përgjatë rrugës kryesore drejt varrezave afër lokalit të Bujar Kukës, dhe deri në fund të fshatit. Kjo pjesë rruge do ndryshohet me emërtimin rruga Shamet Faria, duke marr parasysh, do merren ndryshimet në njësinë Roskovec, është rruga kryesore e Kurjanit, fillon nga kryqëzimi i Kurjanit në Unazën Lindore dhe gjithë rruga përgjatë duke shkuar në fshatin Kurjan do marri emërtimin Rrapo Kuka. Në mbledhjen që është bërë në Shtator është diskutuar me kryepleqtë e fshatrave dhe duke marr

parasysh kontributet e dhëna nga këta persona që po përmendim, emri i Rrapo Kukës ka qënë një nga emrat më të lakuar krahasuar me Shamet Faria, dhe i jepet një mundësi për ta vlerësuar më tepër në rrugen kryesore Roskovec-Kurjan. Kryetarja e bashkisë-idea është kjo, në diskutimet që bëjmë dhe me kryetarët e fshatrave por dhe në komision, ka disa figura kontributi i të cilëve është më i lartë, edhe zgjatja në kohë i detyrave që kanë mbajtur, sepse këta nuk janë persona kot, janë persona ose gjatë viteve dhe në kohë kanë mbajtur pozicione të caktuara, ose në komunitet janë persona që janë dalluar për urtësinë e tyre, kanë ndikuar përshtetë në zgjidhje konfliktesh. Një pjesë e këtyre qytetarëve ne i kemi vlerësuar me titullin “Qytetar nderi”, është vlerësimi më i lartë që jep Këshilli Bashkiak, dhe ndonjëherë ndodh që diskutimet janë të tilla midis nesh, edhe këtu sigurisht, se edhe Këshilli ka të drejtën e vet jo vetëm që i miraton por edhe të japi propozime. Ndodh që një emër i cili ka dhënë shumë kontribut, duhet të marrë emërtimin e një rruge që është më e rëndësishme, se dhe rrugët ndahen në rrugë kryesore, rrugë sekondare, rrugë terciare, rrugë që është më e shkurtër, rrugë që është më e gjatë dhe padyshim kur ti i vendos emrin e një qytetari që ka dhënë më shumë kontribut një rruge kryesore, padyshim që vlerësimi është më i madh. Kur ti i jep emrin, e vlerëson për një rrugë që është më e shkurtër ose në një lagje në brendësi, do të thotë që ky qytetar është i dalluar për atë lagje, në atë komunitet e ka dhënë kontributin, që është një komunitet më i vogël. Ndërsa ky qytetari tjetër, meqënëse ka punuar për një hapsirë më të gjatë, më të gjerë, për një komunitet më të madh, do të thotë që dhe kontributi që ka dhënë është më i madh dhe vlerësimi duhet të jetë më i lartë. Në diskutimet që ne kemi patur herë pas here, për Rrapo Kukën është kërkuar një vlerësim më i lartë, dhe nga diskutimet që kemi bërë edhe me familjarët, por edhe me kryetarët e fshatrave, ne vendosëm që të bëjmë këtë lloj ndërrimi. Rruga që ishte nga kryqëzimi poshtë që shkon për në Vlosh deri në fund tek lokali i Bujarit ishte vendosur për Rrapo Kuka, ta transferojmë për një rrugë në Roskovec, sepse Rrapo Kuka ka shërbyer dhe në Roskovec dhe në Kurjan, është një kontribut që del përtej Kurjanit, dhe ta fillojmë nga rrethrotullimi i ullirit tek rruga e Kurjanit,jo brenda në qytet dhe deri tek kryqëzimi i Kurjanit, pra futet në një rrugë më kryesore, dhe emrin Shamet Faria do ta vendosim në këtë rrugë që ishte më përpara Rrapo Kuka. Një rregullim tjetër që e kemi më poshtë është për një rrugë Dule Tabaku ndryshohet me emërtimin Mehmet Tabaku, kjo sepse kontributi i këtyre dy personave i takon një lagjeje më të vogël, dhe ky rregullim ishte pikërisht në lagjen ku kishte dhënë ai kontributin e vet në atë komunitet më të vogël, është një rregullim për të qënë më i saktë emërtimi. Të tjerat janë emërtime të reja, që ne i kemi marr propozimet nga kryetarët e fshatrave, nga organizata të ndryshme, dhe për më tepër dua tju them se ky është një proces në vazhdimësi. Ne kemi dhe mundësi të tjera që herë pas here, do verifikohen, do merren propozime dhe do ua sjellim përsëri për miratim deri sa i gjithë sistemi i rrugëve të plotësohet, edhe në sistem por edhe në terren me vendosjen e tabelave. Edhe pak rrugë kanë ngelur pa emërtime, nuk janë shumë por nëse qyteti zhvillohet, krijohen rrugë të reja, sepse ne jemi gjithmonë në zhvillim e sipër. Kryetari i Këshillit e hedh ne votim projekt-vendimin dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

10.Raport i monitorimit për 4-mujorin e II viti 2024.

Elmazi-e kemi parë materjalin, kush ka ndonjë pyetje mund ta bëj. Dhurata-dhe ne e kemi lexuar, kisha disa paqartësira por jam e sigurt që edhe prapë nëse pyes, nuk do qartësohem. Selmani-për ato objektet e investimeve, e njëjta gjë është, deri sa të përfundojë financimi. Kryetari i Këshillit-dua tju bëj me dije që ky është thjesht raportim, nuk ka nevojë për ta votuar, thjesht ky është

informacion i detyrueshem që administrata jep përpara këtij Këshilli të nderuar, kështu që përsa kohë jemi të qartë dhe skemi pyetje..Dhurata-jo të paqartë jemi,por meqë sdo marrim përgjigje..Kryetarja e bashkisë-dokumentat dhe i pari PBA-ja dhe ky janë dokumenta që kanë kaluar, plani i investimit bëhet buxhetor, ende nuk kemi ardhur në planin e investimit për vitin 2025,2026,2027. Kjo që ka kaluar deri tani është çfarë kanë qënë planifikuar më përpara, dhe duke qënë që ne përpiqemi të krijojmë një program buxhetor sa më të gjerë për investime, ne jemi përpjekur që ti ndajmë ato në financime në disa vite, sepse që të mbyllen financimet vetëm në një vit, atëherë do kishim më pak investime, por duke qënë që nevojat nëpër fshatra, në zonat e banuara janë ende të porealizuara dhe të papërmbyshura, për shkak edhe të shtrirjes që kemi, dhe të gjithë këtyre viteve në tranzicion, ne përpiqemi çdo vit që të zgjerojmë numrin dhe hartën e investimeve, duke i shtrirë ato në disa vite. Kur të sjellim buxhetin e këtij viti, ne do të fillojmë tani dëgjuesat publike me qytetarët për paketën fiskale dhe për investimet e reja që do të buxhetojmë, dhe aty padyshim do të merren në konsideratë edhe kërkesat që kemi pasur gjatë këtij viti, të shpërndahet kjo në mënyrë të ekuilibruar për çdo lagje, çdo fshat në territorin e bashkisë Roskovec. Asnjëherë nuk ka ndodhur dhe nuk ndodh që unë të shprehem që do bëj atë investim që unë dua, por do bëjmë ato investime që janë të nevojshme sipas prioritetit që kanë dhe sipas mundësisë financiare që ne kemi.

11.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Dhurata-pikë së pari kisha pyetje në lidhje me problematikën që ka ngritur kolegu ynë Gogua, në lidhje me atë zhvendosjen e kazanëve atje. Është e disajta herë që e ka ngritur atë shqetësim, dhe kur jemi mbledhur me Kryetarët e Grupeve është thënë që ka mbaruar ajo punë, është thënë nga vet z.Maksi dhe nuk është bërë asgjë deri tani. Ndërkohë unë e verifikova, për ata 500 nxënës që ka Gogua atje, dhe vinte një aromë që ta shpifte, është gjynah, është për të ardhur keq. Nëse vjen ndonjë kontroll për shëndetin apo për higjenën, nuk e di sesi Gogua e mban atë, tani duam rrugë zgjidhje nga Kryetarja, do ti japi zgjidhje apo jo, sepse është e disajta herë që e kemi ngritur si shqetësim. 2.Banorët e fshatit Suk 1 lagja Agaçaj më kërkojnë që tju pyes çfarë do bëhet me rrugët që kanë mbetur, pjesën e rrugës pa shtruar, sepse ju e përmendët pak më parë, juve ne na qortoni dhe na thoni mos e hidh se është politike, por ndërkohë ju e thatë dhe jeni të parët që na ngacmoni dhe pastaj ne kemi të drejtën e plotë tju kundëpërgjigjemi. Çdo muaj paguajmë taksën e ndriçimit, gjelbërimit, ndërkohë ju e dini lagjen Agaçaj sesi është. Në takimin që keni bërë me ata banorët atje në lokal dhe këtë sduhet ta mohoni, mos e quani politike ju lutem, dhe keni thënë që unë se bëj atë rrugën atje, as rrugën këtej se bëj, mos të përmend emra unë se ku, në bazë të fiseve dhe kjo nuk është e drejtë, se madje të kanë inçizuar, unë nuk e besova se thashë hajde është shtresë e thjeshtë dhe e bëjnë qimen tra, por rezultoi që e kishit thënë. Kryetarja e bashkisë-jeni mësuar me regjistrime, e keni zakon. Dhurata-jo unë jo, të tjerët. Kryetarja e bashkisë-lagja, për lagjen e kisha fjalën. Dhurata-po ti po thua jeni mësuar, mos e përdor këtë fjali, ashtu sikurse edhe ju, si gjithë të tjerët nëse ka padrejtësira, se keni thënë vet nuk e bëj filan rrugë, ta them dhe me emër, se unë nuk kam qënë pjesë e atij komunikimi me ju. Dhe pyetja e fundit, fare ska lekë bashkia për hedhjen e klorit në ato depo, sepse ai ujë që vjen në fshatin Suk 1 vazhdon akoma me ngjyrë dhe me erë, ta shpif. Atje në shkollë ku jam unë ska asnjë lloj detergjenti, u them atyre sanitareve të lutem hidhi pak açe, nuk kemi thonë ato, nga xhepi ynë i kemi blerë, sna ka sjellë bashkia. Nuk e di sa është e vërtetë, por në shkollë sa hyn brenda ka një aromë jo të këndëshme. Që të rrish 7 orë brenda atij


institucioni dhe të mbajë erë të keqe, sepse vetëm me ujë i lajnë ato pastrueset, thonë nuk na del rroga. Nuk e di sa keni sjellë ju detergjent, por ky është realiteti se unë e kam parë. Kryetarja e bashkisë-në dijenin time, unë do ta kontrollojë situatën, di që ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e shkollave për detergjent dhe gjithçka tjetër të nevojshme, por do ta verifikoj, dhe nëse kanë mangësi patjetër që do plotësohen. Në lidhje me klorifikimin e depos, duhet ta dini se shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm nuk varet nga bashkia. Dhurata-më fal kush e bën faturimin, se ata janë banorë të zonës. Kryetarja e bashkisë-ka një ndërmarrje që varet nga Ministria, sigurisht punëtorët nga zona do i marrim, se smund të vij ai nga Fieri në Suk. Dhurata-po tarifa ku shkon? Kryetarja e bashkisë-edhe tarifën e merr Drejtoria e Ujësjellësit, nuk e marrim ne, dhe ata janë personat përgjegjës që sipas ligjit përgjigjen për këtë. Megjithatë kjo nuk do të thotë që ju mos ta ngrini shqetësimin dhe ne mos ta transmetojmë këtë gjë. Patjetër që do ua transmetojmë këtë shqetësim, që të marrin masa. Në lidhje me problemin e investimeve, ato bëhen sipas planifikimit buxhetor, çdo vit në buxhetin që miratohet planifikohen investime për rrugë, ndriçim, gjelbërim etj sipas një ekuilibri duke marr në konsideratë nevojat që ka çdo lagje. Në lagjen Agaçaj nuk mund të thuash si jemi, por është një nga lagjet që përveç 3 segmenteve të shkurtëra, gjithë lagja tjetër është përfunduar me asfaltim, ndërkohë që ka lagje të tjera në territorin e bashkisë Roskovec që janë shumë më keq se lagja Agaçaj. Ne jemi përpjekur dhe do përpiqemi që me fondet që kemi, me hapsirën që krijohet në investime, do të plotësojmë nevojat edhe të lagjes Agaçaj për ato që kanë ngelur pa u asfaltuar dhe të gjithë lagjeve të tjera të cilat kanë ngelur pa u asfaltuar. Ne kemi një specifik, fshatrat i kemi shumë të zgjeruar, nuk i kemi të mbledhur. Fshati Suk 1 ka lagjen Agaçaj, Hoxhenj, Metush, lagjen te materniteti, ka një që futet pranë Arapaj, Hatillarët. Të gjitha këto kanë segmente rrugore që janë ende të paasfaltuara, ende të pandriçuara, dhe të gjitha këto nuk mund të bëhen as me një vit, as me 2 vjet, as me tre vjet. Dhurata-ke bërë selektive. Kryetarja e bashkisë-ne jemi përpjekur dhe do përpiqemi që të gjitha lagjet të mbyllen gradualisht nga një vit në vitin tjetër. Në rrugët që asfaltohen kalojnë dhe të majtë dhe të djathtë, edhe në rrugët e paasfaltuara kalojnë dhe të majtë dhe të djathtë. Dhurata-keni premtuar që në Janar do fillonin rrugët. Kryetarja e bashkisë-ky është këndvështrimi juaj. Dhurata-nuk është këndvështrimi im, kjo është vepër që duket. Kryetarja e bashkisë- në qoftë se ju e keni bërë regjistrimin siç duhet, duhet ta keni kapur të gjithë kontekstin e fjalës, nga fillimi deri në fund, dhe jo të kapni vetëm atë fjalë që thuhet që kjo nuk bëhet tani se nuk ka fond. Kurrë nuk ndodh që unë të them kjo nuk bëhet se nuk dua unë. Ne kemi planifikuar blerjen e disa ndriçuesve me panele diellore të cilat ende nuk kanë ardhur, në momentin që do vijnë menjëherë do fillojmë shpërndarjen e tyre, dhe do bëjmë të mundur të futemi me ndriçim në ato lagje që nuk kanë fare. Në lidhje me kontinierët tek shkolla e Gogos, mua do më vinte mirë që ju ta trajtonit problemin në makro, gjithë problemin e pastrimit dhe jo vetëm problemin e Gogos. Nëse ne duhet ta përmirësojmë këtë shërbim duhet të interesohemi për të gjithë territorin. Ankesa për heqjen e kontinierëve ne kemi në gjithë territorin e bashkisë, por fakti që Gogua është anëtar Këshilli nuk do të thotë që duhet ti dëgjohet zëri më shumë se të tjerët, kërkesat do trajtohen në mënyrë të barabartë për të gjithë. Unë nuk them që Gogua nuk ka të drejtë të kërkojë, ka të drejtë të kërkojë, por ka të drejtë të kërkojë në moralin që duhet për këtë gjë. Unë kërkesën e kam marr nga Maksim si Nënkryetar, i kam kërkuar drejtoreshës së ndërmarrjes që të na sjellë të gjitha vendodhjet e kontinierëve në Roskovec, të shikojmë edhe njëherë si është shpërndarja e tyre në raport me gjithë banorët që hedhin mbetjet, se koshat atje nuk i shërbejnë vetëm Gogos, por gjithë zonës, të bëjmë vlerësimin si janë, dhe duke qënë se ne kemi blerë një sasi tjetër kontinierësh, të bëjmë shpërndarjen edhe të të rinjve aty ku janë prishur, aty ku ka nevoja dhe

të bëjmë një përcaktim më të mirë të vlerësuar të të gjitha pikave ku ne sot kemi kontinierët, ku hedhin mbetjet banorët. Ndërmarrja ka detyrimin që sa më shpejt në mëngjes ti pastrojë ato, mos ti lëri të ngarkuar. Dhurata-mbanin shumë erë. Kryetarja e bashkisë- që të kërkon këtu fuqishëm dhe njëzëri që koshat duhet të jenë të pastruar para se të vijnë nxënësit, kjo është shumë e drejtë, dhe nëse nuk ka ndodhur kjo gjë është për të kërkuar ndjesë, që koshat të pastrohen mirë, të klorifikohet vendi në mënyrë që kur nxënësit të vijnë aty koshat të mos jenë me mbetje. Ndërsa për vendodhjen e koshave nuk mundet që pse e kërkon ti këtë gjë, ne pa e shqyrtuar mirë nevojën se pse janë aty koshat dhe kujt i shërbejnë koshat, nuk mund ta marrim vendimin apriori, se nuk mund të marrim një vendim që të zgjidhim problemin tënd. Dhurata-nuk është problemi i tij por i komunitetit se ke 500 fëmijë aty. Kryetarja e bashkisë-nuk mund të marrim një vendim që të çlirojmë Gogon nga kjo gjë dhe të afektojmë negativisht. Jorgo-Gogua është një anëtar Këshilli që ngre zërin e 500 nxënësve atje, unë nuk po vij për teka ose për të bërë ellozhe, unë po vij se atë pastrimin që bën ti nga ora 6, në orën 7 aty mbushet me qen dhe fëmijët nuk kalojnë dot aty. Kryetarja e bashkisë-do ta bëjmë pastrimin në orën 7. Jorgo-ti e bën, por në orën 7-7³⁰ aty vijnë hedhin mbeturina, ato plehra nuk janë nga lagja ime, vijnë nga lagja e sipërme. Unë kam dhe banjon aty edhe koshat, në gjithë botën koshat janë anës rrugës, aty nuk kalon asnjë përveç nxënësve të shkollës, aty vijnë nxënës, fëmijë për në kopësht të cilët vijnë dhe të shoqëruar me prindër dhe të pa shoqëruar me prindër. Nëse ti e shikon se Gogua është anëtar Këshilli dhe po bën teka e ke gabim. Unë po të ngre një shqetësim që ma kanë ngritur të gjithë prindërit. Po të vini ta shikoni tani ose nga ora 8-9, ik shikoni çka ere vjen, nuk hapet dot dritarja e klasës. Unë nuk po të kërkoj teka por pastrimi dhe higjena është parimore nëpër shkolla, prandaj mos e kap do Gogua teka, jo Gogua sdo teka. Unë ua kam mbyllur gojën atyre prindërve me mirëkuptimin se do ta zgjidhnim, se edhe ata kanë të drejtë të ngrejë shqetësimin. Unë kërkojë një të mirë që i duhet këtij komuniteti, dhe uroj Zotit që ndonjë fëmijë mos ta kafshojnë qentë atje, se nga ora 7-7³⁰ të gjitha pallatet lart vijnë hedhin plehrat aty, dhe qent i ke prezent aty i kam dhe me foto po i deshe. Unë nuk po kërkoj ndonjë privilegj por këtë gjë ju dhe këta këshilltarët duhet ta shikoni me një frymë parimore. Kryetarja e bashkisë-do vij informacioni për të gjithë kontinierët, do bëjmë vlerësimin, nëse rreshti i pallateve sipër do marri kontinier të tjerë që mos ti hedhin aty, do ta shikojmë situatën dhe do të vlerësojmë këtë gjë. Elmazi-sa i përket lagjes tonë ka filluar një punim atje po bëhet një xhade, unë e di vet që nuk mund të bëhen të gjitha. Ne në Këshill kemi vendosur që të bëhet një rrugë, deri më sot unë nuk kam parë gjë. Kryetarja e bashkisë-nuk është rrugë ajo që po bëhet? Elmazi-jo atë e ka bërë pallati ke thënë ti, nuk është ajo rruga që do bësh. Sa i përket koshave une nuk mund të ankohe, se nga të dyja krahët tek mua i ka prurë megjithatë nuk prish punë për mua, do të kërkoja nga ty si zonjë e parë e qytetit pastaj dhe si Kryetare, ti shikosh hidhet klor apo nuk hidhet. Për pastrimin e rrugëve të cilat janë të pashtuara, nuk është e drejta jonë që qytetarët të shkulin ferrat dhe ti grumbullojnë. Sa i përket shtrimit të rrugës që del tek kolektori do bëje mirë ta karikojë. Sa i përket rrugës kryesore po pati mundësi dhe ka fond bashkia të vihen ca ushtar për shpejtësinë e makinave. Kemi avash avash 10 vjet në këtë Këshill dhe vëmendja jonë i është kushtuar vetëm serave, për tokat bujqësore nuk është bërë asnjë gjë, nga 8.8 xhade e Sukut, 8.1 që janë Kapallarët nuk është pastruar asnjë kanal i tretë. Kryetarja e bashkisë-kanalet e treta i pastron fermeri. Elmazi-në gjykimin tënd, e kemi shtruar në Këshill ne dhe kemi thënë 50 lekë/m². Kryetarja e bashkisë-nuk e kemi zbatuar, nuk e zbatojmë dot. Elmazi-lekët mbahen kur ne paguajmë taksat, po deshe verifikoje. Sa i përket rrugëve të brendëshme, ne kemi një skrep apo dy, të bëhen dhe rrugët e blloqeve të sistemohen. Prandaj po të lutem shumë verifikoje dhe shikoj, nëse

sjanë të drejta mos i bëj, nëse janë të ligjshme duhet ti bësh. Të bësh në Arapaj qytezë, të bësh në Agaçaj qytezë dhe të lësh aty është gjynah. Kryetarja e bashkisë-ju falenderoj shumë për gjithë rezyemen që bëre, por ta bëj këtë diskutim dikush jashtë Këshillit unë do isha shumë dakort, por ta bëni ju që ju miratoni buxhetin, investimet. Në këtë Këshill miratohen buxheti, investimet, rrugët dhe gjithçka tjetër. Ju jeni ata që merrni çdo vit sa kemi harxhuar dhe ça do bëjmë, por të thuash tani këtu që ajo rrugë atje nuk qënka nga investimet e bashkisë por qënka nga pallati, nuk shkon, sepse tabela është atje, investimi është nga të ardhurat e bashkisë me fondet tona. Të thuash që nuk po bëhet asgjë për rrugët e parcelave, po ne sa e kaluam në Gusht vendimin kur ndryshuam buxhetin, që një pjesë të mirë të rrugëve të parcelave i kaluam për financim, për prokurim dhe tani presim që duhet të ketë dalë fituesi dhe të filloj puna, në Suk1-Suk2 rruga e Gjanajve e cila lidh gjithë serat, rruga në Kuman, në Vidhishtë, rruga e Vlorës, rruga e pyllit, një rrugë në Vlosh dhe në Ngjeqar. Të gjitha këto janë rrugë parcelash që u shërbejnë fermerëve. A janë mbaruar të gjitha? Sjanë mbaruar, kjo që ne po bëjmë është nga ky buxhet, nga taksat tona. Elmazi-ku ke bërë në Jagodinë? Kryetarja e bashkisë-në Jagodinë është planifikuar rruga nga stacioni që shkon drejt Belinës. A duhet bërë më mirë pastrimi i koshave? Po shumë dakort, e kemi qytetin të pastër? Po, krahasuar me ça e kemi pasur, po e kemi më të pastër, po krahasuar me atë që ne duam ende nuk është bërë, sepse ka dhe punëtor të pandërgjegjshëm, ka dhe drejtues që nuk e bën punën siç duhet, kam dhe unë përgjegjësinë time që nuk e kontrolloj punën siç duhet, të gjitha bashkë. Ai vend i plehrave edhe duhet klorifikuar jam shumë dakort, por ama unë koshat nuk do ti çoj tek shtëpia ime, se koshat do jenë atje ku banojnë banorët, se këtë funksion kanë. Ne e kemi të normuar që për kaq banor duhet të kesh 1 kontinier, çdo me thënë kjo që ti heqim ne, ku do ti çoj koshat? Sa janë ankuar ma hiq koshin këtu ma çoj atje, nëse ne do plotësojmë dëshirat e të gjithëve, ku do ti çojmë koshat? Tek pastrimi ka vend për rregullim, dhe që duhet të bëjmë një pastrim më të mirë jam shumë dakort. Të këmbngulni fort të gjithë bashkë që të thoni në orën 7³⁰ që vijnë fëmijët atje, koshi duhet të jetë i pastër dhe i klorifikuar, këtu po qëndroj në këtë gjë keni të drejtë, por jo që më thoni hiq koshin ti këtu se më vjen mua era, po unë ku ti çoj koshat? Ka një planifikim, ka një ndarje, ku ka mbingarkesë popullsie vendosen më shumë kosha. Do tja lehtësojmë pak barrën në mënyrë që pjesa tjetër e pallateve të mos i hedhi mbetjet aty, do ti çojmë kosha të tjerë pallateve. Të gjitha këto janë nevoja reale që ne duhet ti vlerësojmë dhe të bëjmë shpërndarjen e drejtë të të gjithë investimeve, në mënyrë që pak nga pak, nga viti në vit, këto nevoja të përmbushen, se nuk kanë qënë kështu rrugët siç janë sot para 5 viteve. Dhurata- po dhe taksat nuk kanë qënë kështu para 5 viteve. Kryetarja e bashkisë-dhe taksat në territorin e bashkisë Roskovec mezi arrijnë 80%, dhe ai 20% tjetër nuk i paguan. Dhurata-pyet për tokën e lumit, e cila është gërryer dhe është zhdukur, ndërkohë si do të veprohet se ne paguajmë taksa? Kryetarja e bashkisë-nëse toka është zhdukur nuk ekziston, bëni një kërkesë me shkrim në sistem dhe ne do ta verifikojmë sa tokë ka ngelur. Nëse aty vërtetë nuk ka tokë, do ju zbriten, ske pse e paguan. Kryetari i Këshillit ju bën me dije dhe lexon kthimin e përgjigjeve nga administrata për problemet e ngritura nga këshilltarët në mbledhjen e kaluar. Duke i falenderuar për durimin dhe qetësinë e treguar në ndjekjen e kësaj mbledhje, në zbatim të besimit që na kanë dhënë qytetarët, Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

